



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 41, datë 05.10.2023

PËR

REFUZIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR TË
SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME QARKU SHKODËR Sh.a

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**ligji nr. 8102**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021 "Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime" (**vendimi i KKRR nr.539**) dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr.32, datë 13.09.2023, "Për një ndryshim në vendimin e KKRR nr. 28, datë 23.06.2023 "Për shtyrje të afatit të aplikimit nga shoqëritë ujësjellës kanalizime për tarifa të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura për vitin 2023" (**vendimi i KKRR nr.32**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 05.10.2023, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit mbi kërkesën e Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër sh. a për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

Konstatoi se:

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër ka aplikuar pranë ERRU me shkresën nr. 644 prot, datë 29.09.2023 me lëndë "Kërkesë për nivel të ri tarife për Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura".

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër është një shoqëri e re e themeluar me datë 05.04.2023 me Nipt M37819701O në zbatim të VKM nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura dhe është e pa licencuar nga ERRU.

Bazuar në pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 8102, ku parashikohet se “Personat fizikë apo juridikë, që merren me veprimtarinë e grumbullimit, të shpërndarjes, largimit dhe trajtimit të ujit, për përfitim publik, duhet të pajisen me licencë nga ERRU-ja” dhe në pikën 2 të nenit 22, të ligjit nr.8102 ku citohet se “*Procedura për vendosjen e tarifave fillon me propozimin e bërë nga i licencuari, dhënien e mendimit nga njësitë e qeverisjes vendore dhe përfundon me miratimin përfundimtar të tarifave nga Enti Rregullator*” si dhe referuar pikës 1 të nenit 8 të vendimit të KKRR nr. 539, ku parashikohet se “Vetëm operatorët e licencuar kanë të drejte të aplikojnë për tarifa shërbimi ujësjellës kanalizimesh pranë ERRU-së”, është kusht i domosdoshëm pajisja e shoqërisë me licence për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimit e prapunimit të ujërave të ndotura nga ERRU përpara aplikimit për nivel të ri tarifor.

Për gjithë sa me sipër Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të refuzojë aplikimin për ndryshimin e tarifave të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër
2. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër duhet të aplikojë për licencim pranë Entit Rregullator të Ujit.
3. Drejtoria Teknike Ekonomike ngarkohet të njoftojë Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ndriçim Shani